**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 16.5.2024 | Nr: 48 | Ora: 13:17

# VENDIM

# PËR

# MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES PASZGJEDHORE TË FLETËVE TË VOTIMIT, MATERIALIT ZGJEDHOR DHE PAJISJEVE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK (PEVN) TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023, DHE PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24.09.2023.

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, e 2, 23, pika 8, dhe 167/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S:**

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të 526 (peseqind e njëzet e gjashtë) qendrave të votimit sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. T’i kërkoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative ndaj anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga kqyrja, sipas listës në aneksin 4 te raportit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**